



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 135, datë 02.06.2022

PËR
“MIRATIMIN E RAPORTIT PËR ANALIZIMIN E AFTËSIVE
PROFESIONALE TË PROKURORIT
HYRJET LAMAJ”

Bazuar në nenin 179/b dhe në nenin “E”, të Aneksit “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 40 dhe 42, pika 1, të ligjit Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me raportin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit kalimtar, prokurorit **Hyrjet Lamaj**, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Një kopje e këtij Raporti i dërgohet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 02.06.2022.



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Ludovik Dodaj

ANËTAR
Mirëla Bogdani